



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 05.05.2017, shpallë :

K O N K U R S PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

I. Zyrtar anketues-evidentues për pronat e paluajtshme- 1 pozitë

Drejtoria: Drejtoria për financa, ekonomi dhe zhvillim

Paga mujore(bruto)- 350.00€

Numri i referencës së vendit të punës:01Nr. 05-103/02-14644/17

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e detyrave, shërbimeve lidhur me evidentimin e pronës së paluajtshme; 10%
2. Bënë identifikimin e pronave të paluajtshme të përgjithshme dhe pronareve apo shfrytëzuesve të atyre pronave dhe i shënon në formularë të anketimit; 20%
3. Regjistrojnë të dhënat nga formulari i anketimit për pronat e paluajtshme dhe të dhënat e pronarëve apo shfrytëzuesve të atyre pronave; 15%
4. Verifikon dhe krahason të dhënat e vendosura në sistem përmes formularëve të anketimit dhe ri anketimit me gjendjen ekzistuese në terren; 15%
5. Krijon dosjen e çdo tatimpaguesi të tatimit në pronë, dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe arkivimin e dokumenteve të tatimit në pronë; 15%
6. Identifikojnë personat të cilëve u adresohen faturat tatimore dhe vërejtjet tjera, si dhe marrin nënshkrimet e marrësit të faturës ose vërejtjes; 10%
7. Kryen vizita në prona ndërtimore në terren, shënon numrin e fletës posedues dhe numrin e ngastrave, lokacionin dhe adresën dhe ruan të dhënat në bazën e të dhënave ; 10%
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë:

- Diplomë universitare në ekonomi
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet);.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”

Kohëzgjatja e emërimit : Gjashtë (6) muaj

Data e mbylljes së konkursit; mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit, prej **05.05.2017** deri më **12.05.2017**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Diplomen e Fakultetit të kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera ,kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është në hetim.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranura, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi